



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Priljezja të/Dana 01-02-2024 vllgod			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shënjës Prilog	Vlera Vrednosit
01	060/06		117



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Ligji për Zonat Ekonomike, neni 10 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për formimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Budrik të Epërme

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim, Kuvendi Komunal i Vitisë miraton vendimin për formimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve të pranuar nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për tu vendosur në Parkun Industrial në Budrikë të Epërme.

Komisioni ka këtë përbërje:

1. Burim Sadiku nga ekzekutivi i Komunës, kryesues
2. Ganimete Emini nga ekzekutivi i Komunës, anëtare
3. Ilir Zuka nga Kuvendi i Komunës, anëtar
4. Liridona Bislimi nga Kuvendi i Komunës, anëtar
5. Tefik Salihu nga shoqëria civile, anëtar

Neni 2

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të komisioni është i përkohshëm vetëm për konkursin publik për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Budrikë të Epërme dhe brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Detyra dhe përgjegjësitë e komisionit

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e dokumentacioneve të pranuar nga bizneset afariste, të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për tu vendosur në Parkun Industrial në Budrikë të Epërme, konform procedurave dhe kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike, kriteret e përcaktuara në konkursin publik si dhe në dispozitat e tjera ligjore përkatëse.

Neni 4

Punët administrative – juridike të komisionit

Komisioni në realizimin e detyrave të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe me këtë propozim vendim do t'i ndihmohet në kuadër të kompetencave të tyre nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës, kryesuesi i komisionit.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarëve të komisionit; dhe
3. Arkivit.

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi

